



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

Nr. Serial: 000118

LEJE
PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR
Nr. 10 Prot., datë 26/07/2024

Miratur me:
VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR MAT

Nr.11, datë 15/07/2024

Emri i individit/subjektit:	“UJË PUKA” SH.P.K
I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/ NIPT):	L79004301N
Baseni Ujor:	MAT
Qarku:	SHKODËR
Bashkia/ Njësia administrative:	FUSHË-ARRËZ
Koordinatat: X=501440.63 Y=4658625.04	Z=535
Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji:	AMBALLAZHIM UJI NË SHISHE OSE NË ENË
Prurja mesatare vjetore:	1.1 l/s
Prurja ekologjike:	-
Sasia e ujit që jepet për përdorim:	1.1 l/s
Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka):	-
Vendi ku do të shkarkohet rrjedha e kthyer:	-
Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura:	Lumi Fan i Madh
Sipërfaqja e tokës, me të cilën lidhet përdorimi i ujit (në rastin e ujitjes) nuk ka	
Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka):	Sipas kushteve të lejes
Periudha e vlefshmërisë:	5 VJET
Hyrja në fuqi:	Pas publikimit në regjistrin Kombëtar të licencave dhe lejeve

KRYETARI
GJERGJ PRENDI



Kushtet e posaçme të lejes për përdorim burimi ujqor nëntokësor

1. Të përdorë ujërat në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë leja;
3. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit;
4. Të instalojë, ose të lejojë instalimin e pajisjeve për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;
5. Të regjistrojë vëllimin ditor të ujit të përdorur, përfshirë dhe rrjedhën e kthyer, në një regjistër të posaçëm dhe të raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
6. Në rastin e shfrytëzimit të burimit ujor për hidroenergji, të instalojë një stacion hidrometrologjik, për matjen e prurjeve ditore, në një distancë jo më shumë se 150 m poshtë çdo veprë marrjeje dhe të dhënat t'i raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
7. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore;
8. Leja nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër, pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
9. Të respektojë kushtet e mbrojtjes së mjedisit dhe të rrethojë sipas projektit brezat sanitarë të mbrojtjes.
10. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse të ujit.
11. Të lejojë rrjedhën ekologjike, sipas specifikimeve në leje apo autorizim.
12. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin ujor në rast të një aksidenti, apo incidenti.
13. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin ujor në gjendjen e mëparshme.
14. Të mos çënojë faunën dhe florën ujore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieve të rralla;
15. Të sigurojë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për të mundësuar përdorimin e burimit ujor nga subjekte të tjerë për sasinë e papërdorur.
16. Të zbatojë parimet dhe kushtet të tjera për veprimtarinë të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e burimeve ujore.